



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 69

Datë: 11. 12. 2017, ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.
Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave në Prizren, Klinë, Prishtinë, Rahovec dhe Ferizaj;
3. Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog;
5. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E hapim mbledhjen. A ka dikush ndonjë propozim për rend dite, urdhëroni...?

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare, propozoj të futet në rend dite zëvendësimi i anëtarëve të kuvendeve. Jemi akorduar në këshill, dhe menduam që për shkak të kohës së shkurtër të shkojmë drejtpërdrejtë në mbledhjen e KQZ-së. Janë 7 zëvendësime...
Adnan Rrustemi: Shpendi ka dhënë dorëheqje si asamblist, kish qenë mirë nëse e procedojmë menjëherë në mbledhje.

Illir Gashi: Mendojë se duhet me hi në rend i dite shqyrtimi rreth kërkesës për rishqyrtim të buxhetit. Kurse, sa i përket punëtorisë që është e paraparë, kjo është me plan pune.

Valdete Daka: Do të thotë, një punëtori për planin e punës. Për datat, akordohemi...

Betim Gjoshi: A bënë me në rend dite me hy edhe certifikimi i Ferizajt...?

Valdete Daka: Në rregull, kush është për këtë rend dite?

2. Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave në Prizren, Klinë, Prishtinë, Rahovec dhe Ferizaj

Illir Gashi: Kryetare, nëse më lejohet? Kishte qenë mirë me shkuar ndamas...

Valdete Daka: Atëherë shkojmë me komunën e parë, është Prizreni!

Illir Gashi: Sot, do të vendosim për certifikim e rezultateve duke e parë se, edhe në mbledhjen e kaluar kur i kemi miratuar rezultatet, unë komunën e Prizrenit nuk e kam votuar. Kam votuar kundër rezultateve për arsye të cilat, edhe i kam shpreh në mbledhjen e KQZ-së. Unë, personalisht konsideroj se na është mohuar një e drejtë, pavarësisht se ne do t'i respektojmë rezultatet nga ato vendime që ka ndalur nga instancat më të larta gjyqësore. Për hirë të mos transparencës të mjaftueshme, karshi opinionit publik dhe mijëra qytetarëve që kanë shpreh vullnetin e tyre përmes votës, jam i obliguar që mbi bazën e atyre konstatimeve të votimit, do të abstenoj sa i përket komunës së Prizrenit.

Valdete Daka : Në rregull. Atëherë, kush është për certifikimin e rezultateve për Kryetar Komune në Prizren?

Anëtarët e KQZ-së miratuan certifikimin e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar Komunave në Komunën e Prizrenit me tri vota abstenimi.

Betim Gjoshi: Kryetare, jemi të qartë në raport me procedurat ligjore sa i përket gjykatave edhe institucioneve të ankesave që kanë përfunduar. Kjo, është më shumë si shenjë që, ata nuk i kanë trajtuar qysh duhet institucionet e ankesave. Është rasti i parë që po marrin vendime në të njëjtën ditë që kanë marrë vendim, dhe plot argumente janë që e kanë que si në Istog që po shkojnë në zgjedhje. Ndërsa, një komunë tjetër se kanë que në zgjedhje. Do të thotë, nuk ka trajtim të njëjtë dhe, është mirë që me e rregullua në mënyrë institucionale çështjen e institucioneve kur është në pyetje problemi i ankesave që të kthehen në gjykata të rregullta..

Valdete Daka: Vazhdojmë me komunën e dytë, e që është Klina. Kush është për certifikimin e rezultateve...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan certifikimin e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar Komunave në Komunën e Klinës.

Valdete Daka: Ju faleminderit. Shkojmë me komunën tjetër, e kjo është komuna e Prishtinës. A ka dikush për të thënë lidhur me këtë. Urdhëro Sami...?

Sami Hamiti: Pak a shumë, të gjithë e dini se jemi njësoj edhe në Prishtinë në konceptin e asaj se, një vendim i cili vjen normalisht edhe në kuptimin formal por, unë kam vërejtjet e mia në standardet e dyfishta që janë marrë...Ankimimi jonë ka qenë thjesht te Prishtina, te votat e pavlefshme, dhe votat dhe me ato që thjeshtë janë hetuar... Vërejtje ka, pavarësisht kush i ka marr votat, se ka pasur vota të pavlefshme të cilat janë trajtuar nga komisioner dhe në të vërtetë, kanë qenë të vlefshme dhe po ashtu, votat me kusht...Kërkesa jonë ka qenë që të shihen edhe në pjesën tjetër të jashtëafatshme...Kanë shpallur diçka që realisht s'është trajtuar si duhet...Edhe unë do të abstenoj sigurisht...

Valdete Daka: Kush është për certifikim të rezultateve për komunën e Prishtinës...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan certifikimin e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar Komunave në Komunën e Prishtinës me dy vota abstenim...

Valdete Daka: Ju faleminderit. Janë dy vota abstenimi. Vazhdojmë me Rahovecin. Kush është për certifikimin e këtij rezultati...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan certifikimin e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar Komunave në Komunën e Rahovecit me tri vota abstenimi.

Valdete Daka: E kemi edhe komunën e Ferizajt. A ka dikush diçka...? Nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan certifikimin e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar Komunave në Komunën e Ferizajt.

Betim Gjoshi: Kryetare, nëse më lejohet. Administrata e ka përgatitë vendimin...Dhe në bazë të certifikimit të rezultateve për asamble, ata kanë afat 15 ditëshin e fundit që ta japin betimin, sepse ju skadon afati ligjor me i konstituuar kuvendet...Në ditën e mërkurë, kështu që është mirë sa ma shpejtë me komunikuar edhe me komuna, pra me pushtetin lokal...

Valdete Daka: Sot t'i dërgojmë menjëherë vendimet. Atëherë, shkojmë me pikën tjetër:, certifikimin e Listës Përfundimtare të votuesve për përsëritje të zgjedhjeve për kryetarë komunë në Istog. Pra lista përfundimtare.

3. Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog

Besnik Buzhala: Faleminderit. Përshëndetje të gjithëve. Bazuar në mendimin e panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtrësia numër 1114 2017 dhe vendimin e gjykatës Supreme mbi bazën e të cilave vendime KQZ-ja me datën 2 dhjetorë të 2017-ës kanë nxjerr vendim për miratimin e procedurës për verifikimin dhe konfirmimin e votuesve jashtë Kosovës për zgjedhjet e përsëritura për raundin e dytë për kryetarë komune e cila periudhë do të thotë është realizuar prej datës 2 dhjetorë deri me datën 6 dhjetorë. Në bazë të këtij vendimi d.m.th. është paraparë që të gjithë votuesit të cilët nuk konfirmojnë të dhënat mbi adresën e vendbanimit jashtë Kosovës do të kthehen në listën e votuesve brenda vendit, gjë që ky vendim pra ka bërë ndryshime në listën përfundimtare të votuesve për komunën e Istogut ku votuesit jashtë vendit janë lëvizur do të thotë janë caktuar si votues brenda vendit. Nga kjo periudhë do të thotë nga data 2 dhjetorë deri me datën 6 dhjetor, gjithsej 85 votues do të thotë kanë dërguar konfirmime për adresën e vendbanimit jashtë Kosovës .

Gjithashtu, tha z. Buzhala, kanë dërguar edhe numrin e telefonit ku divizionet i shërbimit votues të gjithë votuesit i kanë kontaktuar përmes telefonit dhe e kemi vërtetë që ata votues të cilët kanë aplikuar përgjatë periudhës së aplikimit kanë dërguar edhe dëshmi për adresën e banimit jashtë Kosovës. Ndërsa nga 5878 votues jashtë Kosovës të regjistruar për zgjedhjet lokale për raundin e parë dhe të dytë kanë pasur mundësi me votuar dhe 1467 emra të votuesve të cilët u kanë dërguar konfirmime do të thotë janë kthyer në listën përfundimtare. kërkoj falje d.m.th. 1467 votues d.m.th. të cilët nuk kanë konfirmuar të dhëna mbi adresën e vendbanimit janë kthyer në listën përfundimtare të votuesve brenda komunës së Istogut ndërsa 85 që kanë dërguar konfirmime ata d.m.th. janë në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe do të kenë mundësi të votojnë përmes postës deri me datën 15 dhjetor 2017. D.m.th. në qoftë se e marrim numrin total të votuesve brenda dhe jashtë votuesve së Kosovës për raundin e parë dhe të dytë kanë pasur mundësi të votojnë 49217 votues. 47683 votues brenda Kosovës në vendvotime, 1587 votues përmes postës d.m.th. jashtë Kosovës. Ndërsa për rivotim numri i votuesve total brenda dhe jashtë Kosovës është 49235 ose 49150 votues do të kenë mundësi të votojnë në vendvotime brenda Kosovës , ndërsa 85 votues do të kenë mundësi të votojnë përmes postës . Nëse i marrim këto dy shifra totale brenda dhe jashtë Kosovës për zgjedhjet që do të mbahen me 17 dhjetor numri i votuesve total ose numri i përgjithshëm i votuesve brenda dhe jashtë Kosovës është 35 votues më pak.

Betim Gjoshi: Unë i përgëzoj për dokumentin është komplet, është fat i mirë është numri i madh i personave të cilët e kanë pasur të drejtën me votuar jashtë vendit të cilët nuk kanë qenë brenda vendit edhe nuk ka ndryshim të madh të listës votuese për një 35 vetë. Për ditët që i ka pas në dispozicion, ka krye punë jashtëzakonisht të mirë shërbimi votues, unë çka kisha kërkuar? Kisha kërkuar që në vendimin për certifikim të listës përfundimtare votuese vetëm të shënohet numri saktë i të dy kategorive të votimit jashtë vendit dhe brenda Kosovës dhe numri total i votuesve ose të thuhet që është aneks i tina është raporti i listës, për çështje tjera me qenë se mundet ndonjë rast me pas ankesa ne duhet me qenë të përgatitur për këtë punë, përndryshe ne e kemi krye atë punë sa e ka lejuar vendimi i PZAP-it në mënyrën më të mirë të mundshme dhe pa e lënduar as një nen të ligjit. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit. Atëherë edhe unë kish propozuar që ky raport ti bashkëngjitet këtij vendimi edhe të thuhet që bashkëngjitur këtij vendimi të jetë raporti i shërbimit të listës së votuesve me të gjitha shpjegimet edhe me numrat e saktë në qoftë se pajtoheni. Atëherë kush është për certifikimin e kësaj liste ashtu siç na e tha Besniku?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog

4. Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog

Kreshnik Spahiu: Faleminderit. Duke u bazuar në numrin e votuesve në listën përfundimtare të votuesve për rivotimin në Istog, kemi 49150 votues, fletëvotimet që do të shtypen janë 47050 apo 4.27% më pak fletëvotime.

Valdete Daka: Atëherë, kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan numrin e fletëvotimeve për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar Komune në Komunën e Istogut

5. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarëve të asambleve komunale

Valdete Daka: Tash, jemi te kjo pika shtesë që është për zëvendësimin i anëtarëve të kuvendeve komunale. Atëherë, Shpëtim Hajredini zëvendëson Shaban Shabanin në komunën e Dragashit nga PDK-ja. Në Deçan, Besnik Hulaj e zëvendëson Malë Lokaj nga LDK-ja. Në Pejë, Atdhe Berisha zëvendëson Gazmend Muhaxherin nga LDK-ja. Në Pejë po ashtu, Islam Husaj zëvendëson Agron Nikqin nga LDK-ja. Në Mitrovicën e Jugut, Alban Fazliu e zëvendëson Avni Kastratin nga PDK-ja. Në Kaqanik, Hajredin Luta e zëvendëson Ylber Bajrën nga AAK-ja. Dhe po ashtu në Kaqanik, Bekim Kogja e zëvendëson Agim Qaken nga Nisma.

Betim Gjoshi: Vetëm diçka desha me potencuar: Mitrovicës së Jugut disa institucione po i referohen si Mitrovica, ndërsa disa të tjera si “Mitrovica e Veriut”. Është mirë me këqyrë edhe ne se, mos jemi duke ju referuar gabimisht...!

Valdete Daka: Atëherë, kush është për zëvendësimin e këtyre asamblistëve?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan zëvendësimin e asamblistëve

6. Shqyrtimi dhe miratimi i mbajtjes së punëtorisë.

Ilir Gashi: Faleminderit. Pra, siç e dini, është paraparë të përgatitet një agjendë për organizimin e një punëtorie të KQZ-së, dhe kjo është e paraparë edhe në planin e punës. Orientimisht, kemi propozime që kjo të organizohet prej datës 22-26 të këtij muaji.. Është mirë që ne të marrim një vendim që lejohet transferi për aq sa duhet me e realizuar punëtorinë...

Valdete Daka: Data e propozuar, është 22 - 26 dhjetor. Vendi i propozuar, është Tirana. Kush është për që të organizohet kjo punëtori me datat e propozuara, dhe vendi i propozuar.

Miradije Meha: Faleminderit. Buxheti që është i aprovuar për udhëtime zyrtare në sekretariat ka qenë në shumë prej 60 mijë euro, prej tyre janë shpenzuar 38910 euro, mjetet e tjera të lira i kemi 18428 mijë euro. prej këtyre mjeteve për mu realizuar këtë udhëtim zyrtar neve na duhet mi bo dy transfere që i kemi se lejohen deri 25% edhe në këtë vit ne duhet me shkuar me këto transfere. Transferi kërkohet prej brenda për brenda buxhetit të udhëtimeve zyrtare, në mëditje nuk kemi të mjaftueshëm buxhet e kemi një mungesë pre 1460 euro, me gjithë atë unë propozova brenda kufijve të lejuar deri 25%- shi me shkuar te këto dy nënkategoritë më na lejuar mundësi që me rrit numrin e pjesëmarrësve në takim që kanë me ardhur në takim. Shuma e transferit njëra është 500 euro edhe tjetra është 1100 euro edhe totali krejt është 1600.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare

=====